



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 222, datë 13.4.2023

P Ë R

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1128, DATË 30.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN
NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT
TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN
DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE
NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr.72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 7, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/193 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/432 ...";
- b) Në pikën 8, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/1277 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/408 ...";
- c) Në pikën 12, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/881 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/421 ...";
- ç) Në pikën 13, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/2376 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/433, (CFSP) 2023/501 ...";
- d) Në fund të pikës 17 shtohen fjalët "... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/457, bashkëlidhur këtij vendimi.";
- dh) Në pikën 24, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/2440 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/431 ...";

- e) Në pikën 25, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/252 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/434 ...".
2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/432, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Në aneksin 8, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/408, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 4. Në aneksin 12, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/421, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 5. Në aneksin 13, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2023/433 dhe (CFSP) 2023/501, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 6. Në aneksin 17, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/457, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 7. Në aneksin 24, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/431, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 8. Në aneksin 25, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/434, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr.72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI


BELINDA BALLUKU

**MINISTRI PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

OLTA XHAÇKA



NR.PROT. 1570/1
DATË 13.04. 2023

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
MINISTRISË SË MBROTJES
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
BANKËS SË SHQIPËRISË
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A circular official stamp of the Ministry of Foreign Affairs of Albania is visible behind the signature. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRISË" at the top and "MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME" at the bottom. The signature is written in black ink over the stamp.

VENDIME**VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2023/501****datë 7 Mars 2023****që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut****KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,**

Duke pasur parasysh Traktatin mbi Bashkimin Europian dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh Vendimin (CFSP) 2020/1999 datë 7 Dhjetor 2020 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut¹ dhe në veçanti Nenin 5(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Çështjet e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Duke pasur parasysh që:

- (1) Me 7 Dhjetor 2020, Këshilli ka miratuar Vendimin (CFSP) 2020/1999.
- (2) Me 8 Dhjetor 2020, në Deklaratën nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Çështjet e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, në emër të Bashkimit Europian, në lidhje me Regjimin e Sanksioneve të të Drejtave të Njeriut Globale të BE, Bashkimi dhe Vendet e tij Anëtare kanë rikonfirmuar angazhimin e tyre të fortë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në botë. Regjimi i Sanksioneve të të Drejtave të Njeriut Globale të BE nënvizon vendosmërinë e Bashkimit për të përmirësuar rolin e tij në trajtimin e shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Arritja e gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut nga kushdo është një synim strategjik i Bashkimit. Respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, rendin ligjor dhe të drejtat e njeriut është një vlerë themelore e Bashkimit dhe politikave të tij të përbashkëta të huaja dhe të sigurisë.
- (3) Në konkluzionet e tij të datës 14 Nëntor 2022, Këshilli ka shprehur shqetësimin rreth efektit disproporcional që konfliktet e armatosura vazhdojnë të kenë mbi gratë dhe vajzat në të gjithë botën, si dhe mbizotërimin e dhunës seksuale dhe gjinore duke përfshirë dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, offline dhe online. Ai është angazhuar për të përmirësuar përpjekjet për të kundërshtuar këtë dhunë me qëllim për të siguruar përgjegjësi të plotë dhe për të luftuar pandëshkueshmërinë. Për më tepër, në konkluzionet e tij në Qershor 2014, Këshilli ka nënvizuar që luftimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës kundër grave kërkon politika të koordinuara në të gjitha nivelet përkatëse dhe një qasje gjithëpërfshirëse që synon çështjet kyçe të parandalimit, nën-raportimit,

¹ OJ L 410 I, 7.12.2020, p. 13.

mbrojtjes, mbështetjes së viktimës dhe ndjekjen e autorëve si dhe masa të tjera. Përdorimi strategjik i masave kufizuese përforcon këtë qasje duke rritur presionin për të parandaluar shkeljet dhe abuzimet e mëtejshme dhe në koordinim me instrumentat e tjerë të Bashkimit në kutinë e mjeteve për të drejtat e njeriut, tërheq vëmendjen për këto shkelje dhe abuzime dhe ato që janë përgjegjës.

- (4) Në këtë kontekst, nëntë persona dhe tre ente duhet të përfshihen në listën e personave fizik dhe juridik, enteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2020/1999.
- (5) Vendimi 2011/101/CFSP duhet si pasojë të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2020/1999 ndryshohet siç përcaktohet në Aneksin e këtij Vendimi. zëvendësohet si më poshtë:

Neni 2

Ky Vendim do të hyjë në fuqi në datën pas publikimit të tij në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit European*.

Bërë në Bruksel, 7 Mars 2023.

Për Këshillin
Presidenti
L. EDHOLM

ANEKSI

Hyrjet e mëposhtme do të shtohen në listën e personave fizik dhe juridik dhe organeve të përcaktuar në seksionin A ('Personat fizik') në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2020/1999:

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
27.	Neda Mohammad NADEEM	Shqiptimi Pashto	Pozicioni: Ministër për Arsimin e Lartë Taleban në detyrë Kombësia: Afgane Seksi: Mashkull	Neda Mohammed Nadeem ka qenë Ministri Taleban në detyrë për Arsimin e Lartë që nga 22 Tetori 2022. Që kur ai mori postin e tij, talebanët kanë publikuar dekrete që ndalojnë gratë nga arsimi i lartë në të gjithë vendin. Këto dekrete i privojnë gruas të drejtën e tyre për arsimim si dhe aksesin e tyre të barabartë në arsim, duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave. Në cilësinë e tij si ushtrues i detyrës së Ministrit Taleban për Arsimin e Lartë, Neda Mohammed Nadeem është përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Afganistan, në veçanti shkeljen e gjerë të të drejtës së grave për arsimim dhe të drejtës për trajtim të barabartë midis burrave dhe grave në fushën e arsimit.	7.3.2023
28.	Sheikh Muhammad Khalid HANAFI	Shqiptimi Pashto	Pozicioni: Ministër Taleban në detyrë për përhapjen e virtytit dhe parandalimin e veseve Data e lindjes: rreth 1970 Vendi i lindjes: fshati Kolam Shaheed, rrethi Doabi, province Nurestan, Afganistan Kombësia: Afgane Seksi: Mashkull	Sheikh Muhamed Khalid Hanafi është Ministër taleban në detyrë për përhapjen e virtytit dhe parandalimin e veseve, duke zëvendësuar ministrin për çështjet e grave. Që kur ai mori postin e tij, talebanët kanë botuar dekrete që kufizojnë lirinë dhe dinjitetin e grave dhe vajzave në të gjithë vendin, duke frenuar lirinë e fjalës dhe të shprehjes së tyre dhe duke ushtruar dënime dhe dhunë të ashpra ndaj atyre që nuk respektojnë dekretet e talebanëve. Në veçanti, gjatë kohës së tij në detyrë, u publikuan dekrete për hixhabin si dhe orare të ndara sipas gjinisë për përdorimin e hapësirave publike. Në cilësinë e tij si Ministër taleban në detyrë për përhapjen e virtytit dhe parandalimin e veseve, Sheikh Muhammad Khalid Hanafi është përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Afganistan, në veçanti për shkeljen e gjerë të të drejtave të grave, siç është liria e tyre e shprehjes, si dhe e drejta për trajtim të barabartë midis burrave dhe grave.	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
29.	Alexander Georgievich FEDORINOV	Shqiptimi Rus	Pozicioni: oficer komandues i Stacionit të Policisë Moskë Kombësia: Ruse Seksi: Mashkull	Nënkoloneli Alexander Georgievich Fedorinov është një oficer komandues i Stacionit të Policisë në Moskë. Në cilësinë e ushtruesit të detyrës së shefit të komisariatit në mars 2022, ka autorizuar arrestimin dhe ndalimin arbitrar, si dhe torturimi i mëpasshëm i protestuesve femrave kundër luftës. Prandaj, Alexander Georgievich Fedorinov është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Rusi, në veçanti torturë dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, arrestime ose ndalime arbitrarë, si dhe dhunë sistematike seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023
30.	Ivan RYABOV	Shqiptimi Rus	Pozicioni: oficer policie i Stacionit të Policisë Moskë Kombësia: Ruse Seksi: Mashkull	Ivan Ryabov është një oficer policie i Stacionit Policor të Moskës. Me urdhër të nënkolonelit Alexander Georgievich Fedorinov, ai arrestoi dhe torturoi në mënyrë arbitrarë protestuese femra kundër luftës në mars 2022. Viktimat raportojnë se ai i rrahu, i mbyti me qese plastike dhe i dhunoi fizikisht dhe verbalisht për gjashtë orë. Prandaj, Ivan Ryabov është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Rusi, në veçanti torturë dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, si dhe arrestime ose ndalime arbitrarë.	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
31.	Nikolay Anatolevich KUZNETSOV a.k.a Nikolaj Anatolevich Kuznetsov, Nikolaj Kuznetsov, Nikolay Kuznetsov	Shqiptimi Rus	<p>Pozicioni: Anëtar i forcave të armatosura të Federatës Ruse, komandant i divizionit Dzerzhinsky të njësisë së forcave special të Rosgvardia (Shërbimi Federal i Trupave Roje Kombëtare të Federatës Ruse)</p> <p>Grada: Gjeneral Major</p> <p>Data e lindjes: 13.4.1978</p> <p>Kombësia: Ruse</p> <p>Seksi: Mashkull</p> <p>Numër identifikimi tatimor: 645407737871</p>	<p>Gjeneral-major Nikolay Anatolevich Kuznetsov është një anëtar i forcave të armatosura të Federatës Ruse dhe komandant i njësisë së forcave speciale të divizionit Dzerzhinsky të Rosgvardia (Shërbimi Federal i Trupave të Gardës Kombëtare të Federatës Ruse).</p> <p>Njësia e Kuznetsov ishte pjesë e pushtimit të paligjshëm rus të Ukrainës dhe anëtarët e njësisë së tij morën pjesë sistematikisht në akte të dhunës seksuale dhe përdhunimi në Ukrainë në mars/prill 2022.</p> <p>Shkalla dhe ashpërsia e akteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore që ndodhin në zonat e pushtuara nga Rusia të Ukrainës flasin për "planifikimin në një nivel më sistematik" dhe komandantët rusë që janë të vetëdijshëm për dhunën seksuale nga personeli ushtarak në Ukrainë dhe, në disa raste duke e "inkurajuar apo edhe urdhëruar".</p> <p>Në cilësinë e tij si komandant i njësisë, Kuznetsov është përgjegjës për shkelje të rënda të drejtave të njeriut në Ukrainë, duke përfshirë dhunën sistematike seksuale dhe me bazë gjinore.</p>	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
32.	Ramil Rakhmatulovich IBATULLIN	Shqiptimi Rus	<p>Pozicioni: Anëtar i forcave të armatosura të Federatës Ruse, ish komandant i divizionit të tankeve të rojeve të 90</p> <p>Grada: Kolonel</p> <p>Data e lindjes: 22.10.1976</p> <p>Kombësia: Ruse</p> <p>Seksi: Mashkull</p> <p>Numër identifikimi tatimor: 631409144707</p> <p>Numri i personelit të forcave të armatosura ruse: U-927425</p>	<p>Koloneli Ramil Rakhmatulovich Ibatullin shërbeu në trupat pushtuese ruse në rajonin e Donbasit (2014-2017) dhe mori pjesë në pushtimin e paligjshëm rus të Ukrainës si komandant i divizionit të tankeve të 90-të të rojeve.</p> <p>Në mars 2022, divizioni nën komandën e tij mori pjesë në ofensivën ndaj Chernihiv dhe Kylv. Gjatë ofensivës, anëtarët e divizionit të tij kryen akte të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore kundër popullsisë civile ukrainase.</p> <p>Pasi këto fakte u bënë publike, Ministria Ruse e Mbrojtjes e gradoi Ibatullin në gradën e kolonelit.</p> <p>Autoritetet ukrainase kanë akuzuar disa anëtarë të divizionit të tankeve të rojeve të 90-të me akuza për dhunë seksuale dhe me bazë gjinore, duke përfshirë përdhunimin e një gruaje shtatzënë pranë Kievit, vrasjen e një civili pasi përdhunoi vazhdimisht gruan e tij në prani të një fëmije të vogël, si dhe pjesëmarrjen e pjesëtarëve të këtij divizioni në përdhunime në grup.</p> <p>Shkalla dhe ashpërsia e akteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore që ndodhin në zonat e pushtuara nga Rusia të Ukrainës flasin për "planifikimin në një nivel më sistematik" dhe komandantët rusë që janë të vetëdijshëm për dhunën seksuale nga personeli ushtarak në Ukrainë dhe, në disa raste, duke "inkurajuar apo edhe urdhëruar".</p> <p>Prandaj, Ibatullin është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Ukrainë, duke përfshirë dhunën sistematike seksuale dhe dhunën me bazë gjinore.</p>	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
33.	Gatluak Nyang HOTH		Pozicioni: Komisioner Qarku për qarkun Mayiandit Kombësia: Sudaneze Jugore Seksi: mashkull	Gatluak Nyang Hoth ka qenë komisioneri i qarkut për qarkun Maylandit (Shteti i Unitetit, Sudani i Jugut) që nga shkurti 2021. Në këtë pozicion, ai komandoi milicitë e lidhura me qeverinë për të kryer sulme në shtetin jugor të Unitetit, midis shkurtit dhe majit 2022. Gjatë kësaj periudhe, trupat nën komandën e tij përdorën gjerësisht dhe sistematikisht dhunën seksuale si një taktikë lufte dhe e instrumentalizuan atë si një shpërblim dhe të drejtë për burrat pjesëmarrës në konflikt. Në cilësinë e tij si komisioner i qarkut, Hoth është prandaj përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Sudanin e Jugut, duke përfshirë dhunën sistematike dhe të përhapur seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023
34.	Gordon Koang BIEL a.k.a Gordon Koang Char BIEL, Koang NYALUALGO		Pozicioni: Komisioner Qarku për qarkun Koch Kombësia: Sudaneze Jugore Seksi: mashkull	Gordon Koang Biel ka qenë komisioneri i qarkut për qarkun Koch (Shteti i Unitetit, Sudani i Jugut) që nga shkurti 2021. Në këtë pozicion, ai komandoi milicitë e lidhura me qeverinë për të kryer sulme në shtetin jugor të Unitetit, midis shkurtit dhe majit 2022. Gjatë kësaj periudhe, trupat nën komandën e tij përdorën gjerësisht dhe sistematikisht dhunën seksuale si një taktikë lufte dhe e instrumentalizuan atë si një shpërblim dhe të drejtë për burrat pjesëmarrës në konflikt. Në cilësinë e tij si komisioner i qarkut, Biel është prandaj përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Sudanin e Jugut, duke përfshirë dhunën sistematike dhe të përhapur seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
35.	Toe Ui		<p>Pozicioni: Zv. Ministër i Punëve të Brendshme</p> <p>Grada: Gjeneral Major</p> <p>Kombësia: Myanmar/Burma</p> <p>Seksi: Mashkull</p>	<p>Gjeneral Major Toe Ui u emërua Zëvendës Ministër i Punëve të Brendshme më 3 shkurt 2023. Ai është ish i dyti në komandën e Zyrës së Shefit të Çështjeve të Sigurisë Ushtarake (OCMSA). OCMSA është përgjegjëse për menaxhimin e qendrave të paraburgimit dhe marrjes në pyetje në Myanmar/Burma dhe ka për detyrë mbledhjen e inteligjencës.</p> <p>Stafi i OCMSA nën autoritetin e Ui përdori lakuriqësi të detyruar, përdhunim, elektroshokë, djegie të organeve gjinitale dhe dhunë të tepruar gjatë ndalimit arbitrar dhe marrjes në pyetje të burrave, grave dhe anëtarëve të komunitetit LGBTIQ.</p> <p>Në cilësinë e tij si i dyti në komandë, general major Toe Ui është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Myanmar/Burma, duke përfshirë ndalime arbitrare dhe tortura, si dhe për dhunën sistematike dhe të përhapur seksuale dhe me bazë gjinore.</p>	7.3.2023'

Hyrjet e mëposhtme do të shtohen në listën e personave fizik dhe juridik, enteve dhe organeve të përcaktuar në seksionin B ('Personat juridik, entet dhe organet') në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2020/1999:

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
'13.	Burgu Qarchak a.k.a. Burgu Gharchak, Zendan-e-Qarchak, Burgu i Grave Qarchak, Burgu Shahr-e Rey	Shqiptimi Farsi	Vendi i regjistrimit: Qarku Varamin, province Tehran, Iran Data e regjistrimit: 2010	Burgu Qarchak është një nga mjediset e paraburgimit të regjimit iranian për gratë në Qarkun Varamin (provinca e Teheranit). Të burgosurit përfshijnë të burgosur politikë dhe pjesëmarrës në protestat paqësore pro-demokratike, si dhe gra shtatzëna dhe nëna me fëmijë. Kushtet e jetesës në burgun Qarchak janë të mjerueshme dhe çnjerëzore. Të paraburgosurat në burgun Qarchak janë subjekt i torturës, përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale. Ata mbahen në qeli të mbipopulluara, pa akses në ujë të pijshëm të pastër, ushqim dhe ndihmë mjekësore, që përbën një trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Të burgosurit e liruar raportojnë raste të abuzimit seksual nga rojet e burgut dhe personeli i sigurisë. Protestueset femra të dërguara në burgun Qarchak shpesh kërcënohen me përdhunim për të nxjerrë rrëfimet. Prandaj, Burgu Qarchak është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran, duke përfshirë torturën dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, si dhe dhunën sistematike seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023

	Emrat (Transliterimi në shkrimin latin)	Emrat	Informacione identifikuese	Arsyet për listim	Data e listimit
14.	Garda Republikane Siriane		Vendi i regjistrimit: Siri Individët e lidhur: Gjeneral Major Shoaeb Suleiman (komandant), Gjeneral Brigade Mohamed Qasem (zv. Komandant), Gjeneral Malik Aliaa (komandant i lartë), Gjeneral Major Issam Zahreddine, Mohammad Nayouf, Rukin Mohamed Kaddor (komandantë), President Bashar Al-Assad	Garda Republikane Siriane është një ent përgjegjës për sigurinë e zyrtarëve dhe pjesë e forcave siriane të sigurisë. Në radhët e saj, dhuna seksuale dhe me bazë gjinore ndaj grave është e përhapur, veçanërisht gjatë konfliktit të vazhdueshëm sirian. Viktimat kanë raportuar përdhunime dhe tortura të dhunshme pas arrestimeve arbitrare dhe gjatë ndalimit arbitrar. Garda Republikane Siriane është pjesë e një qasjeje sistematike të regjimit sirian për të përdorur dhunën seksuale dhe me bazë gjinore për të shtypur dhe frikësuar popullin sirian, veçanërisht gratë dhe vajzat. Prandaj, Garda Republikane Siriane është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Siri, duke përfshirë torturën dhe trajtimin ose dënimin tjetër mizor, çnjerezor ose poshtëruës, arrestimet ose ndalimet arbitrare, si dhe dhunën e përhapur seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023
15.	Zyra e Shefit të Çështjeve të Sigurisë Ushtarake (OCMSA)		Vendi i regjistrimit: Naypyitaw, Myanmar/Burma	Zyra e Shefit të Çështjeve të Sigurisë Ushtarake (OCMSA) është përgjegjëse për menaxhimin e qendrave të paraburgimit dhe marrjes në pyetje në Myanmar/Burma dhe e ngarkuar me mbledhjen e inteligjencës. Stafi i OCMSA përdor lakuriqësi të detyruar, përdhunim, elektrohokë, djegie të organeve gjenitale dhe dhunë të tepruar gjatë ndalimit arbitrar dhe marrjes në pyetje të burrave, grave dhe anëtarëve të komunitetit LGBTIQ. Prandaj, OCMSA është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Myanmar/Burma, duke përfshirë ndalime dhe tortura arbitrare, si dhe për dhunën sistematike dhe të përhapur seksuale dhe me bazë gjinore.	7.3.2023'